A.K.P.A.
Nr 3087 Prot.
Datë,më 19.11.2026

REPUBLIKA E SHQIPERISË
MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
SHKOLLA E MESME TEKNIKE EKONOMIKE DHE HOTELERI – TURIZËM
"ANTONI ATHANAS" SARANDË

Nr. 215 Prot. Sarandë, më : 17/11/2026

Lënda Njoftim për **vend të lirë**
Drejtuar: Drejtorisë Juridike
Drejtorisë Burimeve Njerezore
Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive
Tiranë

Në zbatim të Ligjit 7961 date 12/07/1995 " Kodi I Punes ne Republiken e Shqiperise , ligjit Nr. 15/2019 "Për nxitjen e Punësimit", Ligjit nr. 15 datë 16/02/2017 "Për Arsimin dhe Formimin Profesional në Republikën e Shqipërisë", Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 554, datë 31.07.2019 "Për Krijimin, Mënyrën e Organizimit dhe të Funksionit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive", të Udhëzimit **Nr. 759, datë 30.09.2024"**Për Mënyrën e Organizimit dhe Veprimtarisë së Institucioneve të Arsimit dhe Formimit Profesional, si dhe Aspektet e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore , Përbërjes së Njësisë së Zhvillimit të Ofruesve të Arsimit dhe Formimit Profesional dhe Zhvillimit të Vazhduar Profesional të Personelit", " Shkolla e Mesme Profesionale : "Antonio Athanas", Sarandë , ju njofton për krijimin e nje vendi të lire pune në bazë të Urdhërit nga MEI nr.25 datë 31.10.2025 me Nr.276/3 Prot date 31.10.2025 (për nje mesues me kohë të pjesshme) në pozicionin "Mësues të kulturës profesionale" në profilin mësimor dy vjecar pas të mesmes "Ndërmjetësimin e Pasurive të Paluajtshme" Aplikanti duhet të përmbushë këto kritere:

1. Kritere të përgjithshme:
a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë tëkryejë detyrën;
c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së
prerë për kryerjen e veprave penale;

d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nukjanë shuar;
e) të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljesdhe komunikimit;
f) të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe të

2. Kritere të posaçme për personelin mësimdhënës të formimit teorik-praktik në ofruesit e formimit profesional:

a) të ketë diplomë të nivelit master profesional *os*e të barazvlefshme, në të njëjtën fushë me njërin nga kualifikimet profesionale të ofruesit të AFP-së ***profili: Inxhinier /IT 1(një)***
b) të ketë të paktën *1 (nje) vit përvojë* pune në fushën, në të cilën ka kryer studimet;
c) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit;

Dokumentet e aplikimit.

Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë:
- Letërmotivimin për pozicionin;
- Jetëshkrimin (Cv-ne sipas shtojcës 11 të udhëzimit **nr. 759, datë 30.09.2024)**
- Kartën e identitetit;
- Diplomën;
- Librezën e punës;
- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet , trajnimet apo të tjera të përmendura në CV:
- Çertificatën ose dëshminë për nivelin e njohurive në teknologjinë e inforrnacionit;
- Vërtetimin e gjëndjes shëndetësore;
-Vërtetimin e gjëndjes gjyqësore:
- Vërtetimin nga punëdhënësi i fundit, që ndaj tij ,nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi
-Të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënës të mëparshëm.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose të noterizuara; Dokumentet në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyera dhe të noterizuara. Dokumentet e aplikimit dorëzohen në protokollin e ofruesit të AFP-së brenda datës 27. 11 .2026.

Vlerësimi i kandidatëve do të bëhet referuar përcaktimeve të udhëzimit nr.759 datë 30.09.2024 "për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë,menaxhimin e burimeve njerëzore, përbërjen e njësisë së zhvillimit të institucioneve,ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesionaltë personelit"

Drejtori
Rudina Liçaj

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHKOLLA E MESME TEKNIKE EKONOMIKE DHE HOTELERI-TURIZEM
"ANTON ATHANAS"
SARANDË